



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.407 /2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Nisma Qytetare për Ferizaj (NQF), dega në Ferizaj, për shkak të shpifjeve në tubime publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 31.10.2013, nga subjekti politik PDK dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se iniciativa qytetare NQF dhe kandidati i tyre për kryetar për Komunën e Ferizajit, gjatë fushatës zgjedhore në tubimet publike, si dhe në debatet publike të mbajtura në televizione nëpërmjet kandidatit të tyre për Kryetar Komune në Ferizaj, kanë shpifur dhe nxitur urrejtje publike ndaj subjektit politik PDK dhe kandidatit për kryetar komune të subjektit politik PDK në Ferizaj, me të cilat deklarata publike sipas parashtruesit të ankesës kanë bërë shkelje të dispozitave ligjore për Zgjedhjet Lokale, Rregullën Zgjedhore nr 11/2012 në nenin 4 alineja 4.1 (k), Kodin e Procedurës Penale, si dhe Ligjin Civil kundër shpifjes dhe fyerjes.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë materiale linqet nga deklaratimet publike .

PZAP-i, e informoi Nismën Qytetare për Ferizaj (NQF), në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, me datë 31.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 01.11.2013.

PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga Nisma Qytetare për Ferizaj (NQF), sipas afatit të caktuar, ku NQF thekson se kjo ankesë nuk ka bazë dhe është tendencioze, për të shtypur fjalën e lirë dhe shpresoj që ju si institucion nuk do të bini pre e këtyre akuzave me prapavijë politike dhe nuk ka të bëjë me asnjë shpifje dhe fyerje, por me një fakt të pakontestueshëm se unë jam shkelur me anashkalimin në debatin e Klan Kosova. Po ashtu NQF në përgjigjen e

ofruar potencon se në fushatën e tyre nuk ka pasur gjuhë të urrejtjes, shpifje apo fyerje siç pretendohet në ankesë dhe këtë mund ta dëshmoni me argumentet e ofruara, të cilët nga ju kërkoj ti merrni si prova dhe të hedhni poshtë ankesën e bërë nga subjekti politik PDK.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se në tubime publike gjatë fushatës zgjedhore NQF nëpërmjet kandidatit të tyre për Kryetar Komune për Ferizaj se me deklarata publike kanë nxitur shpifje dhe urrejtje ndaj subjektit politik PDK, PZAP-i i konsideron se janë të pa bazuara dhe të pa argumentuara, sepse nga dëshmia e ofruar nga parashtuesi i ankesës nuk është dëshmi bindëse me të cilën vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar dhe nuk është e mjaftueshme për të vërtetuar shkeljen e supozuar. Andaj PZAP-i ,konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu vërtetuar, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa në Prishtinë

Anr. 407/2013 më datën 04.11.2013

Kryesuesi i Panelit

Nehat Idrizi



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*